

Vendim nr. 105 datë 20.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Y) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **YLLI XHAKOLLI, ERVEHE XHAKOLLI, MEVLUTE TARE, HAXHI TARE, FLORENCA BRAHO, FIDAHI BRAHO,** të përfaqësuar nga avokat Konstandin Tradafili.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2973, datë 14.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 239, datë 06.02.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.00-2023-3575, datë 20.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë ose në Gjykatën e Apelit Tiranë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, shkronja “f”, 134, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të tre personave që në datën 21.08.2005 kanë humbur jetën si pasojë e një aksidenti automobilistik. Në aksident ka humbur jetën edhe drejtuesi i automjetit, i cili ka qenë edhe përdorues i policës së sigurimit, datë 19.05.2005, me periudhë mbulimi 19.05.2005–18.05.2006, të siguruar pranë shoqërisë së sigurimeve “Intersig“ sh.a. (*shoqëria e sigurimit*).

2. Për këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. 719 të vitit 2005. Sipas aktit të ekspertimit autoteknik ka rezultuar se aksidenti ka ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit nga vetë drejtuesi i mjetit dhe në kushtet kur autori i shkeljes ka humbur jetën, prokuroria, me vendimin e datës 26.09.2005 ka vendosur pushimin e hetimeve për çështjen penale.

3. Fillimisht, kërkuesit i janë drejtuar shoqërisë së sigurimit me kërkesë për dëmshpërblim, e cila në datën 26.04.2006 ka urdhëruar pagesën e dëmit në vlerat 1.193.081 lekë (për dy prej tyre) dhe 1.187.133 lekë (për të tretin). Këto vlera janë kundërshtuar nga kërkuesit në gjykatë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1991, datë 05.03.2008, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke urdhëruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesit në vlerat 3.912.500 lekë dhe 3.920.926 lekë. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 862, datë 25.06.2009, ka pranuar në tërësi padinë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesit në vlerat 9.396.306 lekë, 8.461.872 lekë dhe 15.864.116 lekë. Ndërsa rekursi i paraqitur nga shoqëria e sigurimit nuk është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2011-1696, datë 28.10.2011, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Mbi kërkesën e shoqërisë së sigurimit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2824 (461), datë 23.10.2012, ka vendosur prishjen e tre vendimeve gjyqësore dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues, me qëllim kryerjen e një ekspertimi të ri për vlerësimin e dëmit, duke caktuar ekspertë kompetentë të fushës sipas kërkesave ligjore.

6. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2973, datë 14.04.2015, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin pjesërisht të padisë dhe ka detyruar shoqërinë e sigurimit të paguajë në favor të kërkuësve shumat prej 4.037.333 lekësh, interesat në vlerën 2.258.390 lekë deri në datën 15.04.2014 dhe interesin ditor prej kësaj date deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi në vlerën 827,9 lekë, si shumën prej 1.884.254 lekësh, interesat në vlerën 1.242.299 lekë deri në datën 15.04.2014 dhe interesin ditor prej kësaj date deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi në vlerën 455,4 lekë.

7. Mbi ankimin e palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 239, datë 06.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për sa u takon masave të dëmshpërblimit, me arsyetimin se gjykata më e ulët ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, pasi të gjitha pretendimeve dhe prapësimeve të pjesëmarrësve në gjykim u ka dhënë përgjigje në përputhje me ligjin dhe provat e ndodhura në dosje.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3575, datë 20.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së.

9. Me shkresën nr. 6487/1 prot., datë 12.12.2023, Gjykata e Lartë ka lëshuar vërtetimin për kërkuësit, sipas të cilit vendimi nr. 00-2023-3575, datë 20.09.2023, është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 13.11.2023.

10. Në datën 11.03.2024 kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuësve

11. ***Kërkuësit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar:

11.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga nenet 42 dhe 142 të Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi rekursi është ushtruar në datën 01.03.2017, referuar parashikimit ligjor të nenit 472 të KPC-së të asaj kohe, ndërsa vendimi është marrë sipas standardit të sotëm të pranimit të rekursit, ndërkohë që duhej t'u referohej kritereve që kanë qenë në fuqi në momentin e paraqitjes së tij. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka shkelur parimin e veprimit të ligjit në kohë e hapësirë, të fuqisë prapavepruese të tij. Po kështu, Gjykata e Lartë, duke mos vepruar sipas ligjit të kohës kur

është paraqitur rekursi, ka kufizuar padrejtësisht të drejtën e aksesit për shqyrtimin e të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs.

- 11.1.2. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka identifikuar, analizuar, verifikuar dhe kuptuar shkaqet e rekursit që kishin të bënin me shkeljet e ligjit material dhe procedural të lejuara nga gjykatat e faktit. Ndërsa ajo gjykatë shprehet se nuk mund të rivlerësonte provat, kur një gjë e tillë nuk ishte ngritur si pretendim në shkaqet e rekursit, ndërkohë ka anashkaluar pretendimet lidhur me mosmarrjen në konsideratë nga gjykata e apelit të provave të dorëzuara në seancë dhe të rëndësishme për procesin, sikurse shkresa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
- 11.1.3. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat nuk kanë shqyrtuar dhe vlerësuar provat e paraqitura që kishin rëndësi për procesin, duke dhënë vendime në shkelje të rregullave procedurale gjyqësore. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe jo në seancë gjyqësore, duke mos marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, kohën e gjatë të gjykimit prej 18 vjetësh, rigjykimin sërish prej saj dhe vënien në diskutim të çështjeve të ligjit dhe që vendimet e gjykatave binin ndesh me praktikën gjyqësore. Kjo ka sjellë që kërkuesit të mos merrnin përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në rekurs.
- 11.1.4. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse dispononte të dhënat e kontaktit të përfaqësuesit të kërkuesve, nuk ka kryer njoftimin individual në adresën e tij, duke mos u dhënë mundësinë atyre për t'u mbrojtur dhe për të parashtruar pretendimet e tyre. Mosthirrja në gjykim e palëve ka cenuar edhe *parimin e kontradiktoritetit* në gjykim. Gjithashtu edhe gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë, nga pikëpamja substanciale, provat e paraqitura prej tyre, të cilat ishin të një rëndësie të tillë që mund të ndryshonin rrjedhën e gjykimit dhe vendimmarrjes, si dhe nuk i ka pasqyruar ato formalisht në vendimin e saj.
- 11.1.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi dhe nuk ka argumentuar se përse nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e ngritura në rekurs dhe përse nuk ka shkelje të ligjit material dhe procedural ose të praktikës gjyqësore të saj. Ajo i shmanget dhënies së argumenteve dhe provave, nuk merr parasysh provat e paraqitura prej tyre, duke dhënë konkluzione kategorike dhe të rumbullakosura, si dhe duke keqinterpretuar faktet e ligjin. Pretendimet e ngritura në rekurs janë të

gjitha të natyrës ligjore dhe Gjykata e Lartë duhej të shprehej për to sipas parashikimeve të ligjit të kohës kur rekursi është paraqitur.

11.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, lidhur me vlerën e dëmshpërblimit që atyre u takonte në respektim të limitit të përgjegjësisë në përputhje me ligjin. Kështu, sipas tyre, fillimisht gjykatat kanë disponuar me vendim të formës së prerë, që u respektonte limitin prej 50.000.000 lekësh dhe që u njihte të drejtën për të përfituar interes pasuror, të cilin e kanë gëzuar efektivisht pasi ka filluar ekzekutimi i tij, ndërkohë që rishikimi i vendimit dhe vijimi i procedurave të rigjyimit u ka cenuar atyre këtë të drejtë kushtetuese. E drejta për të përfituar shpërblim nga dëmi jopasuror është mbështetur në vendimin unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*) i cili ka plotësuar boshllëkun edhe në këtë aspekt. E drejta e pronës së bashku me *parimin e pritshmërive të ligjshme dhe të sigurisë juridike* është cenuar edhe nga vendimi nr. 461, datë 23.10.2012 i Gjykatës së Lartë që ka pranuar kërkesën për rishikimin e vendimeve të gjykatave të fakteve, ndërkohë që çështja ishte gjë e gjykuar dhe vendimi kishte filluar të ekzekutohej.

11.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi për sa i takon limitit të përgjegjësisë, gjykatat duhej të interpretonin dhe zbatonin ligjin sikurse kanë vepruar edhe në çështje të tjera, në varësi të numrit të personave të dëmtuar. Sipas kërkesve, ndërsa në rastet e tjera me më shumë se një të dëmtuar është zbatuar limiti 50.000.0000 lekë, në çështjen e tyre është zbatuar limiti për dëmet materiale 5.000.000 lekë. Metodologjia e zbatuar duhej të ishte sipas udhëzimit nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” (*udhëzimi nr. 24/2007*), i cili, pavarësisht se ka hyrë në fuqi në vitin 2007, gjen zbatim edhe në rastin e tyre, pasi çështja ishte kthyer për rigjykim. Po kështu, gjykatat në përlogaritjen e vlerës i janë referuar masës së pensionit minimal në fshat, i cili është disa herë më i ulët sesa ai në qytet, ndërkohë që viktimat ishin banorë të Bashkisë Sukth dhe banonin në qytet.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesve

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe

2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kolegji vlerëson se kërkuuesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë trashëgimtarët ligjorë të tri viktimave të aksidentit automobilistik që kanë vënë në lëvizje procesin gjyqësor për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor duke qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kolegji konstaton se kërkuuesit i janë drejtuar Gjykatës në datën 11.03.2024 me ankim kushtetues individual duke paraqitur pretendime ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur prishjen e vendimeve të procesit gjyqësor dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë (datë 23.10.2012), si dhe ndaj atij që ka përmbyllur procesin gjyqësor pas rishqyrtimit të çështjes (datë 20.09.2023).

18. Lidhur me vendimin e datës 23.10.2012 të Gjykatës së Lartë, kërkuuesit kanë pretenduar se ai u ka cenuar të drejtën kushtetuese të pronës së bashku me parimin e pritshmërive të ligjshme

dhe të sigurisë juridike, ndërkohë që çështja ishte gjë e gjykuar dhe vendimi kishte filluar të ekzekutohej. Lidhur me këto pretendime, Kolegji vëren se ato janë paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor, pasi vendimi është dhënë përpara më shumë se 11 vjetësh, ndaj kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*. Ndërsa për vendimin e datës 20.09.2023 Gjykata e Lartë ka informuar se ai është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 13.11.2023, që është edhe momenti kur kërkuesit konsiderohen se kanë marrë dijeni efektivisht për të, ndaj pretendimet e tyre për këtë vendim konsiderohen të paraqitura brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të drejtën e pronës dhe parimin e barazisë përpara ligjit, të garantuara nga nenet 18, 41, 42 dhe 142 të Kushtetutës. Për sa i përket së drejtës për proces të rregullt ligjor, ata kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për akses, së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

20. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, kërkuesit kanë parashtruar se Gjykata e Lartë, ndonëse dispononte të dhënat e kontaktit të përfaqësuesit të kërkuesve, nuk ka kryer njoftimin individual në adresën e tij, duke mos u dhënë mundësinë atyre për t'u mbrojtur dhe për të parashtruar pretendimet e tyre.

21. Kolegji, referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, vëren se komunikimi i njoftimit në adresën e kontaktit të përfaqësuesit ligjor të palëve nga Gjykata e Lartë parashikohet në nenin 482, pika 3, të KPC-së, të rregullat që normojnë shqyrtimin në themel të shkaqeve të rekursit. Ndërkohë, në rastin e kërkuesve, Gjykata e Lartë, bazuar në nenet 480, shkronja "a" dhe 485, pika 1, të KPC-së, ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit të tyre, që do të thotë se ajo i ka dhënë fund shqyrtimit të rekursit që në fazën seleksionuese. Për rrjedhojë, komunikimi elektronik i parashikuar nga neni 482, pika 3, i KPC-së nuk gjen zbatim në rastin e kërkuesve, ndaj pretendimi i tyre për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar për shkak të moskomunikimit në adresën elektronike të përfaqësuesit ligjor të datës së shqyrtimit të rekursit, nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Nga ana tjetër, Kolegji vë në dukje se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i depozituar nga vetë kërkuesit, njoftimi për shqyrtimin e të cilit në dhomën e këshillimit gjendet i publikuar në rubrikën e çështjeve të planifikuara për shqyrtim në datën 20.09.2023 dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen elektronike të asaj gjykate, që do të thotë se ata kanë pasur mundësi të njihen në kohë me njoftimin dhe të paraqesin parashtrime shtesë përfshirë edhe kundërshtimin për shqyrtimin e tij në dhomën e këshillimit, për rrjedhojë edhe pretendimet për cenimin e parimit të

kontradiktoritetit për shkak të mosthirrjes në gjykim dhe së drejtës së aksesit për shkak të formës së gjykimit nuk qëndrojnë.

23. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës së pronës*, kërkuesit e kanë mbështetur me argumentin se gjykatat nuk kanë respektuar limitin e përgjegjësisë, gjë e cila ndikon në vlerën e dëmshpërblimit që atyre u takonte. Sipas tyre, fillimisht, gjykatat kanë disponuar me vendim të formës së prerë, që u respektonte limitin prej 50.000.000 lekësh dhe që u njihte të drejtën për të përfituar interes pasuror, të cilin e kanë gëzuar efektivisht pasi ka filluar ekzekutimi i tij. Po kështu, e drejta për të përfituar shpërblim nga dëmi jopasuror është mbështetur në vendimin unifikues nr. 12/2007, i cili ka plotësuar boshllëkun edhe në këtë aspekt. Ndërsa lidhur me cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, kërkuesit kanë argumentuar se gjykatat duhej të interpretonin dhe zbatonin ligjin, sikurse kanë vepruar edhe në çështje të tjera, në varësi të numrit të personave të dëmtuar, ku në rastet me më shumë se një të dëmtuar është zbatuar limiti 50.000.0000 lekë, ndërsa në çështjen e tyre është zbatuar limiti për dëmet materiale 5.000.000 lekë. Metodologjia e zbatuar duhej të ishte sipas udhëzimit nr. 24/2007, i cili pavarësisht se ka hyrë në fuqi në vitin 2007, gjen zbatim edhe në rastin e tyre, pasi çështja është kthyer për rigjykim. Po kështu, gjykatat, në përlllogaritjen e vlerës, i janë referuar masës së pensionit minimal në fshat, i cili është disa herë më ulët sesa ai në qytet, ndërkohë që viktimat ishin banorë të Bashkisë Sukth dhe banonin në qytet.

24. Kolegji vëren se për shkak të kthimit të çështjes për rishqyrtim mosmarrëveshja ndërmjet palëve ende nuk ishte zgjidhur përfundimisht në themel. Nga ana tjetër, argumenti se gjykatat kanë dhënë vendime të ndryshme nga rastet e tjera lidhet me interpretimin e ligjit dhe me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykatat në kontekst të fakteve dhe provave të çështjes konkrete dhe sipas specifikave përkatëse. Kjo do të thotë se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, në varësi të rrethanave dhe faktorëve që nuk mund të jenë të njëjtë. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pas rishqyrtimit të çështjes, kanë qenë në të njëjtën qasje lidhur me vlerësimin e fakteve dhe provave të administruara dhe me interpretimin që ato u kanë bërë akteve ligjore dhe nënligjore të zbatueshme, si për sa i takon limitit të përgjegjësisë, ashtu edhe lidhur me kërkimin për dëmin jopasuror, si një drejtë e cila ishte shuar dhe parashkruar. Për rrjedhojë, në kushtet kur argumentet janë të natyrës ligjore dhe lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit në raport me faktet dhe provat e administruara gjatë gjykimit nga gjykatat e zakonshme, pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës* dhe *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk mund të merren në shqyrtim.

25. Lidhur me pretendimin për cenimin e *së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit dhe parimit të kontradiktoritetit*, kërkuesit kanë argumentuar se

Gjykata e Lartë nuk ka identifikuar, analizuar, verifikuar dhe kuptuar shkaqet e rekursit që kishin të bënin me shkeljet e ligjit material dhe procedural të lejuara nga gjykatat e faktit. Sipas tyre, ajo gjykatë shprehet se nuk mund të rivlerësojë provat, kur një gjë e tillë nuk është ngritur si pretendim në shkaqet e rekursit, ndërkohë ka anashkaluar pretendimet lidhur me mosmarrjen në konsideratë nga gjykata e apelit të provave të dorëzuara në seancë dhe të rëndësishme për procesin që mund të ndryshonin rrjedhën e gjykimit, gjë e cila ka sjellë vendime në shkelje të rregullave procedurale gjyqësore. Ndërsa Gjykata e Lartë, sipas kërkesve, nuk ka marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, kohën e gjatë të gjykimit prej 18 vjetësh, rigjykimin sërish prej saj të së njëjtës çështje dhe vënien në diskutim të ligjit dhe që vendimet e gjykatave binin ndesh me praktikën gjyqësore. Kjo ka sjellë që kërkesit të mos marrin përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në rekurs. Po kështu, sipas kërkesve, provat e paraqitura prej tyre nuk janë pasqyruar formalisht në vendimin e gjykatës së apelit, duke i vendosur ata në pozita të pafavorshme kundrejt palës tjetër. Kolegji, duke pasur parasysh thelbin e këtyre argumenteve, çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme

26. Kërkesit kanë pretenduar se rekursi është ushtruar në datën 01.03.2017, referuar parashikimit ligjor të nenit 472 të KPC-së të asaj kohe, ndërsa vendimi është marrë sipas standardit të sotëm të pranimit të rekursit, ndërkohë që duhej t'u referohej kriterëve që kanë qenë në fuqi në momentin e paraqitjes së tij. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka shkelur parimin e veprimit të ligjit në kohë e hapësirë, të fuqisë prapavepruese të tij.

27. Gjykata ka theksuar se parimi i sigurisë juridike garanton parashikueshmërinë e sistemit normativ. Nxjerrja e normave juridike nuk i shërben vetëm zgjidhjes së një konflikti të mundshëm ose rregullimit të një situatë të parregulluar më parë. Ky proces duhet të krijojë përshtypjen te subjektet e së drejtës se përmbajtja e normave juridike garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 2, datë 18.02.2013; nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa i takon zbatimin në kohë të ligjit, Gjykata është shprehur se edhe pse Kushtetuta nuk përmban një rregull të veçantë në këtë drejtim, me përjashtim të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues (*neni 29, pika 3*) dhe ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit për taksat, tatimet dhe detyrimet financiare (*neni 155*), zbatimi i ligjit në kohë lidhet me shtetin e së drejtës dhe procesin e rregullt ligjor, në kuptimin që siguria juridike kërkon që kushdo të jetë në gjendje të parashikojë se si zbatohet ligji në një situatë të caktuar (*shih vendimin nr. 1, datë 26.01.2021 të*

Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, vepron parimi *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009; nr. 11, datë 19.09.1995 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se efekti prapaveprues i ligjit procedural është përjashtim që vendoset nga ligjvënësi sipas kriterëve specifike, me qëllim që të mos ndikojë në mënyrë arbitrare në të drejtat tashmë të fituara nga të tretët.

29. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesit e kanë depozituar rekursin në datën 01.03.2017, ndërsa është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 21.04.2017, pra përpara ndryshimit të nenit 472 të KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ndërsa Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar dhe ka dhënë vendimin e saj në datën 20.09.2023, pra pas ndryshimit të kësaj dispozite me ligjin nr. 38/2017. Për rrjedhojë, në përputhje me parashikimin e bërë në dispozitën kalimtare të ligjit nr. 44/2021, vlerësimi i kriterëve të pranueshmërisë së rekursit bëhej sipas parashikimeve të KPC-së në kohën e depozitimit të tij në datën 01.03.2023. Ndërkohë çështja e zbatimit në kohë të ligjit procedural ka gjetur trajtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se në rastin e rekurseve, të cilat janë depozituar dhe regjistruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2021, në funksion edhe të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, për efektet e pranueshmërisë së rekursit mbahet parasysh ligji i kohës së regjistrimit të tyre (*shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në vijim ajo gjykatë ka arsyetuar se, bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 44/2021, pavarësisht kohës së regjistrimit të rekursit, për sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjykimit, si dhe mënyrës se si gjykata disponon, ajo u referohet dispozitave që janë aktualisht në fuqi (*shih paragrafin 25 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po sipas Gjykatës së Lartë, referuar nenit 472 të KPC-së, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, si dispozita e zbatueshme për vlerësimin e pranueshmërisë ose jo të shkaqeve të rekursit, rezulton se rekursi në fjalë është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga kjo dispozitë (*shih paragrafët 26 dhe 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

30. Për sa më lart, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë ka zbatuar ligjin procedural të kohës së paraqitjes së rekursit në lidhje me kriteret e pranueshmërisë së tij, ku në përfundim ka vlerësuar se ai nuk i ka plotësuar ato, ndaj pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat nuk kanë shqyrtuar dhe vlerësuar provat e paraqitura që kishin rëndësi për procesin, duke dhënë vendime në shkelje të rregullave procedurale gjyqësore. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe jo në seancë gjyqësore, duke mos marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, kohën e gjatë të gjykimit prej 18 vjetësh, rigjykimin sërish prej saj dhe vënien në diskutim të çështjeve të ligjit dhe që vendimet e gjykatave binin ndesh me praktikën gjyqësore. Kjo ka sjellë që kërkuesit të mos merrnin përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në rekurs. Ajo, duke mos vepruar sipas ligjit të kohës kur është paraqitur rekursi, ka kufizuar padrejtësisht të drejtën e aksesit për shqyrtimin e të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs. Gjykata e Lartë nuk ka identifikuar, analizuar, verifikuar dhe kuptuar shkaqet e rekursit që kishin të bënin me shkeljet e ligjit material dhe procedural të lejuara nga gjykatat e faktit. Ndërsa ajo gjykatë shprehet se nuk mund të rivlerësojë provat, kur një gjë e tillë nuk është ngritur si pretendim, ndërkohë ka anashkaluar pretendimet lidhur me mosmarrjen në konsideratë nga gjykata e apelit të provave të dorëzuara në seancë dhe të rëndësishme për procesin, sikurse shkresa e AMF-së.

32. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi dhe nuk ka argumentuar se përse nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e ngritura në rekurs dhe përse nuk ka shkelje të ligjit material dhe procedural ose të praktikës gjyqësore të saj. Ajo, sipas tyre, i shmanget dhënies së argumenteve dhe provave, nuk merr parasysh provat e paraqitura nga kërkuesit, duke dhënë konkluzione kategorike dhe të rrumbullakosura, si dhe duke keqinterpretuar faktet e ligjin. Pretendimet e ngritura në rekurs janë të gjitha të natyrës ligjore dhe Gjykata e Lartë duhej të shprehej për to sipas parashikimeve të ligjit të kohës kur rekursi është paraqitur.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjithashtu, sipas Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin

pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimin të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimin nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Nga ana tjetër, Gjykata ka pranuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vënë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Duke iu kthyer rastit në shqyrtimi, Kolegji konstaton se në rigjykim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se përlllogaritja e dëmit pasuror do të bëhet për 3 vjetët me të fundit të punës, duke marrë parasysh të ardhurat neto sipas dokumentacionit italian, pasi të zbritet tatimi mbi të ardhurat e personave fizikë, dhe për pjesën që të ndjerët kanë qenë pa punë, duhet të merret trefishi i shumës vjetore të pensionit më të ulët sipas legjislacionit shqiptar për sigurimet shoqërore, referuar përcaktimeve të rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992 “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” (*rregullorja nr. 622/1-1992*). Sipas gjykatës, referuar varianteve të kryera nga eksperti vlerësues i dëmeve në sigurime, në aktin e datës 28.05.2014, bazuar në rregulloren nr. 622/1-1992, vlera e dëmit pasuror e një prej të ndjerëve ka rezultuar në masën 7.480.662 lekë, për të dytin në masën 7.945.327 lekë dhe për viktimën e tretë në masën 2.846.921 lekë. Po kështu, sipas gjykatës, referuar nenit 13 të dekretit nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, të ndryshuar me ligjin nr. 7641, datë 01.12.1992 dhe ligjin nr. 8279, datë 18.01.2001 (*dekreti nr. 295/1992*), personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë drejtpërdrejt nga siguroesi, brenda kufijve të përgjegjësisë së tij sipas kontratës së sigurimit, shpërblimin e dëmit. Në zbatim të neneve 10, 11, 13 dhe pikës 1/c të tabelës “Lista e vleftave minimale të shumës së siguruar”, dëmi pasuror është kufizuar në vlerën 5.000.000 lekë sipas limiteve që mund të përgjigjet një shoqëri sigurimi, sipas policës së sigurimit që ka lëshuar. Duke

qenë se vlerat e dëmeve pasurore tejkalohen sipas përlllogaritjes së dëmit, atëherë vlera e dëmit pasuror që do të përgjigjet shoqëria e sigurimit do të jetë deri në vlerën e përcaktuar nga limiti.

38. Gjithashtu, gjykata ka argumentuar se kërkimi i dëmit jopasuror duhet rrëzuar për shkak se kjo e drejtë është shuar, duke qenë se nuk është ngritur në gjykimet e mëparshme dhe rezulton të jetë edhe i parashkruar, referuar neneve 493, paragrafi tretë, dhe 117 të KPC-së. Sipas gjykatës, duke qenë se ky është një dëm jokontraktor, padia dhe kërkimi i dëmit jopasuror duhet të bëhet brenda afatit 3-vjeçar, nga momenti që paditësve u ka lindur e drejta e kërkimit të këtij dëmi. Për shkak se e drejta e kërkimit të dëmit jopasuror nuk është realizuar brenda afatit 3- vjeçar, bazuar në nenin 112 të Kodit Civil, kjo e drejtë është shuar dhe nuk mund të realizohet më.

39. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka arsyetuar se humbja e jetës së viktimave nga aksidenti automobilistik është shkaktuar në datën 21.08.2005 dhe legjislacioni i zbatueshëm janë dekreti nr. 295/1992, rregullorja nr. 622/1-1992, si dhe nenet 450, 608, 609, 625 dhe 640 të Kodit Civil. Ajo gjykatë, ka vënë në dukje se edhe vendimi unifikues nr. 12/2007 i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, për ngjarjet e sigurimit, që kanë ndodhur përpara daljes së tij, referon caktimin e dëmshpërblimit sipas akteve ligjore e nënligjore të kohës, e konkretisht rregullores nr. 622/1-1992. Ndërsa udhëzimi nr. 24/2007, nuk gjen zbatim, pasi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 160, datë 03.12.2017, për këtë shkak ai ka hyrë në fuqi në atë datë, ndërkohë që ngjarja ka ndodhur 2 vjet më parë (21.08.2005) dhe rrjedhimisht nuk mund të zbatohet as metodologjia e përcaktuar prej tij për përlllogaritjen e dëmit pasuror sipas të ardhurave të vitit të fundit përpara aksidentit. Sipas gjykatës së apelit, çështja është dërguar për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 23.01.2012 dhe bazuar në nenin 493, paragrafi i tretë, të KPC-së, në rigjykim palët nuk mund të ngrenë pretendime të ndryshme nga ato të pranuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, përveç nevojës për të arritur në përfundime që dalin nga vendimi i Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur shpërblimi për dëmin jopasuror nuk është kërkuar në gjykimet e mëparshme, por vetëm në procesin e rigjyimit, kërkimi për të nuk duhet pranuar. Gjykata e apelit ka konkluduar se rezulton plotësisht e provuar se plotësohen të gjitha kushtet për ekzistencën e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore (veprimet e kundërligjshme me faj, me pasojë ekzistencën e dëmit, me lidhje shkakësore midis veprimit të kundërligjshëm dhe pasojës së ardhur) dhe, për rrjedhojë, edhe e drejta për dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar, për shkak të dëmit që paditësve u është shkaktuar në aksidentin automobilistik të datës 21.08.2005.

40. Në vijim, Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, ka arsyetuar se çështja është regjistruar pranë saj në datën 21.04.2017 dhe duke qenë se të dyja palët ndërgjyqëse kanë paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjyimit, në referim të rrethanave specifike të konstatuara, sidomos të

faktit që çështja ishte paraqitur për t'u shqyrtuar për herë të tretë në atë gjykatë, ka vlerësuar se ekzistonin shkaqe objektive ligjore për shqyrtimin me përparësi të saj, kjo edhe me qëllim mbarëvajtjen e çështjeve gjyqësore, eficiencës dhe uljen e ngarkesës (*shih paragrafin 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato, vendimi i saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe nuk vihen re shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjykimit. Ndërsa për sa i takon pjesës së pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, ato dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka konkluduar se rekursi nuk pranohet, pasi ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, të listuara në mënyrë taksative në përmbajtje të nenit 472 të KPC-së.

41. Kolegji, duke analizuar ecurinë e rigjykimit të çështjes së kërkuesve në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe përmbajtjen e vendimeve të dhëna në këtë fazë, konstaton se pretendimeve të tyre në ankim dhe rekurs u është dhënë përgjigje nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ata kanë ushtruar të drejtën e aksesit në gjykata, pasi kanë vënë në lëvizje nëpërmjet ankimit gjykatën e apelit dhe rekursit Gjykatën e Lartë, ndërsa vlerësimi i shkaqeve të rekursit, nga kjo e fundit, sipas ligjit të kohës, nuk rezulton të ketë sjellë cenim të kësaj të drejte.

42. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka analizuar shkaqet e ankimit në raport me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, veçanërisht për sa i takon legjislacionit të zbatueshëm dhe masës takuese të dëmshpërblimit. Ndërsa lidhur me shkresën e datës 16.01.2017 të AMF-së, e cila nuk pasqyrohet e cituar në përmbajtje të vendimit të gjykatës së apelit, sikurse rezulton nga mendimi i gjyqtarit në pakicë, ajo është marrë në shqyrtim nga gjykata pas pranimit të kërkesës për përsëritjen e pjesshme të hetimit gjyqësor (*shih paragrafin e fundit të faqes së parë të mendimit të pakicës që shoqëron vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë*).

43. Për sa i takon vendimit të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh edhe natyrën e gjykimit në atë gjykatë, arsyetimi i kufizuar i vendimit nuk cenon në vetvete standardet kushtetuese, duke qenë tashmë një formë e konsoliduar në praktikën e saj. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka elaboruar mjaftueshëm edhe faktin se çështja po shqyrtohej me përparësi për shkak të kërkesës së paraqitur nga palët dhe kompleksitetit të saj. Po kështu, argumenti i Gjykatës së Lartë se ajo nuk mund të rivlerësojë provat, ndërsa kërkuesit pretendojnë se ata nuk e kanë ngritur një pretendim të tillë, nuk përbën arsye që cenon standardin e arsyetimit të vendimit, pasi ky është një vlerësim me natyrë të përgjithshme dhe mbështetet në thelbin e shkaqeve të rekursit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit

të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

44. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.